


18.07.2022  
02/404



# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI 2022-2025

MES

KOMUNËS SË SHITES

DHE

FONDACIONI JESHIL

Sot me datën \_\_\_\_\_ në Shtime,

Komuna e Shtimes, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu,

dhe

Organizata joqeveritare mjedisore Fondacioni Jeshil, me numër regjistrimi 5200309-1, me zyre në rr. Ismail Dumoshi 120, 10 000, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Xhevdet Gegollaj (në vijim: "Fondacioni Jeshil"),

më tutje në tekst, Palët, lidhin këtë:

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

- Të vëmendshëm për gjendjen e mjedisit në Komunën e Shtimes dhe nevojën për veprim në gjetjen e zgjidhjeve praktike për të adresuar sfidat kritike të tranzicionit të gjelbër;
- Të zotuar për krijimin e një hapësire të favorshme për angazhimin e shoqërisë civile, dhe rritjen e mbështetjes së institucioneve ndaj nismave vendore;
- Duke njohur nevojën për të vepruar tani për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike, në mbështetje të zhvillimit dhe zbatimit të projekteve dhe ideve që shtyjnë përpara mirëqenien e qytetarëve të Komunës së Shtimes;

Prandaj, Palët janë PAJTUAR si në vijim:

### Neni 1: Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është themelimi i një mekanizmi bashkëpunues në mes të Palëve për të fuqizuar kapacitetet Komunale në Shtime në trajtimin e mbeturinave organike, sigurinë ushqimore, bujqësinë e qëndrueshme dhe zhvillimin e ekonomisë qarkore.

### Neni 2: Fushat e bashkëpunimit

Fushat e bashkëpunimit në mes të Palëve përfshijnë hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta që promovojnë zgjidhje inovative dhe miqësore ndaj mjedisit për mbeturina organike – përfshirë mbeturinat ushqimore, intervenime në fushat e ekonomisë qarkore, zhvillimin e tregut vendor të plehrave organike, edukimin mjedisor dhe dietën e shëndetshme për fëmijët.

### Neni 3: Objektivat specifike

- Ndërtimi i kapaciteteve institucionale vendore në menaxhimin e mbetjeve organike përmes zhvillimit të sistemit për kompostimin e mbeturinave organike në Komunën e Shtimes;
- Promovimi i kompostimit në institucione publike;

- Shfrytëzimi i platformës *foodsafe community* për reduktimin e mbeturinave ushqimore dhe shpërndarjen e ushqimit të grumbulluar, potencialisht edhe përmes themelimit të një *food bank* në Shtime;
- Angazhimi për hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta në fushën e mjedisit;
- Promovimi i ekonomisë rrethore në fushat e ushqimit dhe mbeturinave organike;
- Pjesëmarrje në zhvillimin e politikave, buxhetim dhe monitorimin e zbatimit;
- Projektet të përbashkëta me komuna tjera, brenda dhe jashtë vendit;
- Aktivitetet tjera sipas nevojës.

#### **Neni 4: Zotimet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës**

Obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës janë si në vijim:

- Komuna definon pjesët/fushat në të cilat ka nevojë për intervenim;
- Komuna cakton, siguron dhe mundëson të gjitha lejet e nevojshme për intervenim
- Bashkëfinancimi i Komunës do të përcaktohet paraprakisht për secilin projekt veçmas, bazuar në procedurat dhe ligjet në fuqi dhe kërkesave të donatorit;
- Emërimi i një zyrtari komunal për të qenë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjes;
- Koordinimi i aktiviteteve gjatë zbatimit të projektit;
- Shkëmbimi i informacioneve relevante për projekte të përbashkëta;
- Siguron pjesëmarrjen e Fondacionit Jeshil në grupet punuese relevante.

#### **Neni 5: Zotimet, detyrat dhe përgjegjësitë e Fondacionit Jeshil**

Obligimet dhe përgjegjësitë e Fondacionit Jeshil janë si në vijim:

- Fondacioni Jeshil ofron njohuri dhe përvojën në kuadër të fushave të bashkëpunimit në mes dy palëve;
- Fondacioni Jeshil cakton një person kontakti në cilësinë e koordinatorit, i cili do të kujdeset për mbarëvajtjen e zbatimit të marrëveshjes;
- Hartimi dhe zbatimi i intervenimit/projektit;
- Menaxhimi i përgjithshëm administrativ dhe financiar i projekteve të përbashkëta;
- Realizimi i prokurimeve të nevojshme për realizimin e intervenimit;
- Përfaqëson projektin para partnerëve të projektit dhe palëve të jashtme të interesuara;
- Raportimi i progresit të projektit;
- Komunikimi direkt dhe indirekt me partnerët e projektit;
- Mbështet bashkëpunimin ndërmjet partnerëve të projektit;
- Merr pjesë aktivisht në grupe punuese.

#### **Neni 6: Aktivitetet**

Aktivitetet e Palëve në suaza të kësaj Marrëveshjeje janë si më poshtë:

- Riprodhimi dhe përshkallëzimi i modeleve të zbatuara nga Fondacioni Jeshil në fushat e menaxhimit të mbeturinave organike përmes kompostimit, reduktimit të mbeturinave ushqimore, *foodsafe community*, Klasat në Natyrë, etj.;
- Ndarje i njohurive dhe eksperiencës në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi në hartim, shqyrtim dhe amandamentimi i politikave mjedisore komunale;

- Bashkëpunimi rreth organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere në fushat e sipër-përmendura;
- Bashkëpunim në fuqizimin e rinisë në angazhimin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe aktiviteteve tjera komunitare;
- Organizimi i konsultimeve me ekspertë të mjedisit përmes seminareve, tryezave të rrumbullakëta dhe grupeve punuese për projektet e caktuara;
- Organizimi i aktiviteteve sipas nevojës kontekstuale dhe me pajtim të dyanshëm.

#### Neni 7. Kohëzgjatja e Projektit

Zbatimi i Marrëveshjes fillon nga dita e nënshkrimit nga të dyja palët, dhe do të zbatohet për një periudhë **tri (3) vjeçare 2022-2025**, me mundësi vazhdimi me pajtim reciprok të dy Palëve.

#### Neni 8. Zgjidhja e Marrëveshjes


1. Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet para afatit të skadimit të saj me akordimin e të dy Palëve, apo me kërkesë të njëres Palë, me lajmërim paraprak me shkrim prej 30 ditësh.
2. Pala e pakënaqur me përformancën e Palës tjetër, në përputhshmëri me Nenin 1, dhe sipas detyrimeve këtu të marra, mund të zgjedhin Marrëveshjen me njoftim paraprak prej 2 muajsh.
3. Meqë Palët lidhin këtë Marrëveshje me mirëbesim dhe për qëllime të përfitimit të Palëve të treta në nevojë, zgjidhja e Marrëveshjes do të jetë pa pasojë për cilëndo Palë, përpos nëse Pala që ka kërkuar zgjidhjen e Marrëveshjes, për arsytet e shënuara në paragrafin 2 më sipër, pëson ndonjë dëm material nga mosperformanca e Palës tjetër.
4. Në rast të dëmit eventual, të pësuar nga cilado Palë, kompetente për gjykimin e të njëjtit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.

#### Neni 9. Dispozitat kalimtare

1. Kjo Marrëveshje qeveriset sipas dispozitave të ligjeve në fuqi në Kosovë.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e palëve.

Kjo Marrëveshje përgatitet në dy versione origjinale, nga një për secilën Palë.


Komuna e Shtimes

  
z. Qemajl Aliu  
Kryetari i Komunës

Shtime, me 18.07.2022



Fondacioni Jeshil

  
z. Xhevdet Gegollaj  
Drejtor Ekzekutiv

Shtime, me 18/07/2022

